



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

R R E G U L L O R E

**“PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19 NË AMBIENTET E PUNËS SË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 42 të ligjit 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, miratuar me Vendimin nr. 18, datë 11.03.2015, të Komisionerit, nisur nga situata në të cilën ndodhet vendi për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19,

VENDOSI :

Neni 1

Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Neni 2

Qëllimi i Rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë:

1. Parandalimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
2. Sigurimin e kushteve të punës dhe mjeteve të përshtatshme për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve të KMSHC-së.
3. Vijmësinë sa më normale të veprimtarisë së institucionit.

Neni 3

Masat e përgjithshme të higjienës

1. Në ambientet e KMSHC-së duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i produkteve të higjienës, ku përfshihen sapun i duarve, dezinfektant me bazë alkooli që përmban të paktën 60-95% alkool, letër për pastrimin e duarve, letra apo peceta prej cope dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve të ndryshme. Për pastrim dhe dezinfektim mund të përdoren produktet që përdoren zakonisht për këto qëllime.
2. Koshat për hedhjen e mbeturinave në çdo zyrë duhet të pajisen me qese të cilat të ndërrohen në fund të ditës së punës.
3. Punonjësit duhet t'i sigurohet në mënyrë të vazhdueshme pajisja me mjete mbrojtëse personale si maska dhe doreza.
4. Duhet të praktikohet pastrimi i vazhdueshëm dhe i shpeshtë i të gjitha sipërfaqeve si: tavolinat e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Produktet dezinfektues që përdoren për pastrim të kenë përqindjen e alkoolit sipas pikës 1 të këtij neni, në mënyrë dhe kohën e aplikimit. Në çdo rast përdorimi i tyre bëhet duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale.
5. Në rast se sipërfaqet në vendin e punës janë të ndotura, duhet të pastrohen duke përdorur një pastrues ose sapun dhe ujë para dezinfektimit.
6. Për shmangien e përhapjes së infeksionit në ambientet e punës së KMSHC-së nga persona që nuk janë pjesë e stafit të institucionit, në ambientin hyrës të tij duhet të vendoset një dezinfektant me bazë alkooli që përmban të paktën 60-95% alkool, i dedikuar vetëm për këta persona. Përdorimi i tij është i detyrueshëm për të patur akses në ambientet e tjera.

Neni 4

Detyrimet e strukturës përgjegjëse

1. Struktura përgjegjëse për zbatimin e kësaj Rregulloreje është Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
2. Struktura përgjegjëse duhet të vendosë në një vend të përshtatshëm dhe të dallueshëm në ambientin hyrës, në çdo kat, si dhe në ambientet e përbashkëta postera udhëzues/inkurajues për zbatimin e rregullave të etikës dhe higjienës së duarve.
3. Struktura përgjegjëse duhet të monitorojë vazhdimisht sigurimin e distancimit social dhe, nëse kapaciteti i punonjësve kalon normën e lejuar për sipërfaqe në m² duke respektuar distancën fizike 1.5-2m, i propozon strukturave të tjera të institucionit që së bashku të hartojnë një politikë të brendshme për përmirësimin e organizimit të punës, e cila mund të përfshijë:
 - a. Zbatimin e vendeve të punës fleksibël (p.sh., punë në distancë);
 - b. Zbatimin e orëve fleksibël të punës (p.sh. ndërrime të orarit të punës/ditëve të punës);

- c. Rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve në vendin e punës;
 - d. Rritjen e hapësirës fizike midis punonjësve dhe qytetarëve (p.sh., përmes ndarjeve);
 - e. Zbatimin e opsioneve fleksibël të takimit dhe udhëtimit (p.sh., shtyrja e takimeve ose ngjarjeve jo thelbësore);
 - f. Uljen e disa shërbimeve ;
 - g. Ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e detyrave nga distanca (p.sh. telefon, video ose web).
4. Struktura përgjegjëse duhet të vendosë elementët e distancimit fizik me shenja vizuale të dukshme në sipërfaqen e dyshemesë.
 5. Në ambientet e KMSHC-së duhet të ketë një mjedis të caktuar për të izoluar një punonjës, i cili mund të shfaqë shenja klinike të sëmundjes dhe më pas lajmërohet menjëherë 127-ta dhe Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor përkatës.
 6. Struktura përgjegjëse, për aq sa është e mundur, duhet të vendosë kamera të survejancës për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjienës dhe kujdesit zbatohen me përpikmëri.
 7. Struktura përgjegjëse duhet të përmirësojë kontrollet inxhinierike, duke monitoruar sistemin e ventilimit të ambjenteve. Kjo mund të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:
 - a. Rritjen e niveleve të ventilimit;
 - b. Rritjen e përqindjes së ajrit në natyrë që qarkullon në sistem.

Neni 5

Detyrimet e punonjësit

1. Punonjësi, me qëllim ruajtjen e shëndetit vetjak dhe të kolegëve, duhet të kujdeset që të zbatojë me përpikmëri të gjitha rregullat e parashikuara në këtë rregullore.
2. Punonjësi është i detyruar të deklarojë pranë strukturës përgjegjëse nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me Covid-19. Në rast se punonjësi ka pasur apo ka kontakt të ngushtë me një person me Covid- 19, duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse, e cila më pas njofton Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor përkatës.
3. Punonjësi duhet të përdorë mjetet e mbrojtjes personale si maska dhe doreza, si dhe të lajë shpesh duart me ujë dhe sapun ose pastrojë ato duke i fërkuar me pastrues me bazë alkooli *(me përqindjen e alkoolit siç është përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje)*;
4. Punonjësi duhet të lajë duart ose të përdorë dezinfektant *(me përqindjen e alkoolit siç është përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje)* përpara vendosjes apo heqjes së maskës. Maska duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbulojë plotësisht fytyrën nga maja e hundës deri tek mjekra dhe duhet të hiqet duke e kapur vetëm tek pjesa e lidhëseve anësore dhe jo tek pjesa e përparme.
5. Punonjësi duhet të lajë duart ose të përdorë dezinfektant *(me përqindjen e alkoolit siç është përcaktuar në nenin 3 të kësaj rregulloreje)* pas heqjes së dorezave. Dorezat duhen hequr

në mënyrë të tillë që duart të mos prekin sipërfaqen e jashtme të tyre dhe të hidhen menjëherë në koshin e mbeturinave.

6. Punonjësi duhet të evitojë kontaktin fizik si formë përshëndetje dhe të ruajë distancimin fizik prej së paku 1,5 (një e gjysëm) m me kolegët apo persona të tjerë.
7. Punonjësi duhet të bëjë kujdes që gjatë kollitjes apo teshtimës të mbulojë gojën dhe hundën me gropëzën e bërrylit ose shami letre. Shamia e letrës duhet hedhur në koshin e mbeturinave dhe menjëherë më pas duhen larë duart.
8. Punonjësi nuk duhet të përdorë telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punonjësve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, ato duhet të pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas përdorimit.

Neni 6 Dispozitat e fundit

Ngarkohet për zbatimin e kësaj rregullore struktura përgjegjëse e KMSHC-së.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA